



International
Labour
Organization

Projekti "Përgjigjet në nivel lokal ndaj sfidës së punësimit të të rinjve në Shqipëri"

Thirrje për shprehje interesi

Trajnim për ngritjen e kapacitetit të stafit të Agjencisë Rajonale për Zhvillim në Kukës në fushën e Menaxhimit të Ciklit të Projektit dhe mbi teknikat e mbledhjes së fondeve.

I. Vështrim i përgjithshëm

Projekti për Adresimin në Nivel Lokal të Sfidës së Punësimit të të Rinjve i financuar nga SDC (Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim) vlerëson rolin kyç që autoritetet rajonale/lokale mund të luajnë në trajtimin e sfidave të tregjeve lokale të punës, si edhe masat e ndërmarra nga institucionet qendrore. Bazuar në eksperiencën e mëparshme në kuadrin e Projektit të Përbashkët të OKB për Punësimin dhe Migrimin e të Rinjve (PMR), kjo ndërhyrje synon konsolidimin dhe zgjerimin e përfshirjes së komuniteteve lokale në përpjekjet për zgjidhjen e problemeve të papunësisë. Paktet Territoriale të Punësimit (PTP) përfaqësojnë një risi institucionale e cila është e bazuar në konsultime dhe në planifikim të negociuar midis aktorëve publikë dhe privatë në nivel kombëtar dhe lokal, aktorë të cilët bashkohen për hartimin e objektivave të punësimit duke e vënë theksin tek formalizimi i punëtorëve të rinj dhe krijimi i vendeve të punës.

Paktet projektohen si partneritete nga poshtë-lart me qëllim që të nxisin iniciativat dhe skemat që e trajtojnë papunësinë që në rrënjë. Në të njëjtën kohë masat e PTP-së mbështesin politikatat të cilat shënjestrojnë zhvillimin dhe formalizimin e sektorit të bujqësisë duke promovuar formalizimin e ndërmarrjeve të vogla (mikro), veçanërisht në zonat e thella.

Ngritja dhe funksionimi i Bordeve Rajonale të Punësimit, të cilët institucionalizojnë rrjetet e aktorëve lokalë, e rrit besimin në lidhje me mundësinë e përsëritjes së këtij modeli përtej kohëzgjatjes së projektit. Modeli i PTP, si instrument efikas i cili mundëson nxitjen e mënyrave të reja të bashkëpunimit dhe ndërveprimit, është duke u rimarr në qarkun e

Kukësit dhe Shkodrës dhe po testohet për herë të parë në qarkun e Lezhës. Qasjet e reja ndaj problemit kompleks të papunësisë, njohuritë teknike mbi praktikat lokale dhe mësimet e nxjerra mund të shërbejnë edhe përtej kohëzgjatjes së Projektit dhe gjithashtu mund t'ju vijnë në ndihmë edhe aktorëve dhe subjekteve të tjera vendore, të cilët synojnë të kryejnë ndërhyrje të të njëjtit lloj, të hartojnë përgjigje politike, ose të dyja.

II. Përshkrimi i shërbimeve

Strategjitë e zhvillimit ekonomik kërkojnë agjensi zbatuese për të siguruar kryerjen e të gjitha veprimeve dhe krijimin e kushteve për tërheqjen e investimeve në rast nevoje.

Në qershor të vitit 2011, Këshilli Rajonal i Kukësit miratoi "Strategjinë për Zhvillim Rajonal 2012 – 2016" e cila siguron një tablo të përditësuar të prioriteteve dhe masave të nevojshme për sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik dhe social. Në këtë kuadër, kjo strategji duhet të mbështetet nga një agjensi ekzekutive e cila ka kapacitetin e duhur për t'i përkthyer direktivat strategjike në masa konkrete duke e bërë atë edhe më efikase. Agjencia Rajonale për Zhvillim (ARZH) konsiderohet si një partnere e përbashkët e Këshillit Rajonal të Kukësit, sektorit të biznesit dhe aktorëve të tjerë në nivel komuniteti.

Aktivitetet e mëposhtme synojnë arritjen e objektivave të caktuara:

- Organizimi i programeve të trajnimit për ngritjen e kapaciteteve të stafit të Agjencisë Rajonale për Zhvillim (ARZH) si edhe të drejtuesve të zyrave të zhvillimit të bashkive/komunave në lidhje me Menaxhimin e Ciklit të Projektit (MCP): hartimi/përgatitja e propozimit të projektit, zbatimi, menaxhimi dhe mbledhja e fondeve.
- Sigurimi i paisjeve të nevojshme për ARZH-në, me qëllim krijimin e kushteve për arritjen e misionit dhe objektivave të saj (jo pjesë e kësaj kontrate).

III. Detyrat kryesore dhe produktet e pritshme

Ofruesi i trajnimit për këtë prokurim ka për detyrë:

Të ofrojë trajnim për 10 anëtarë të stafit të ARZH-së dhe të Këshillit Rajonal të Kukësit në lidhje me kompetencat e nevojshme për identifikimin e projekteve, analizën e aktorëve, hartimin e projektit si edhe ngritjen e sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit. Kursi bazohet tek qasja e kuadrit logjik.

Kursi do të përfshijë temat e mëposhtme:

- Analiza e projektit:
 - identifikimi i aktorëve;
 - ndërtimi i "pemës" së problemeve dhe i "pemës" së objektivave;
- Hartimi/dizenjimi i projektit:
 - kuadri logjik;

- logjika e ndërhyrjes;
- treguesit;
- analiza e rrezikut.
- Planifikimi i projektit:
 - struktura e Ndarjes së Punës (SNP);
 - akordimi/përcaktimi i burimeve dhe i matricës së përgjegjësisë;
- Monitorimi, Raportimi dhe Vlerësimi i Projektit:
 - monitorimi dhe vlerësimi i projektit;
 - llojet e vlerësimit;
 - raportimi mbi projektin.

Kursi do të zgjasë 4 ditë dhe do të përdorë një metodologji që nxit pjesëmarrjen aktive, duke kombinuar prezantimin interaktiv të temave me diskutimet plenare dhe detyra në grup të cilat janë hartuar me qëllim inkurajimin e punës në ekip si edhe për të matur arritjet e të nxënit. Referenca për hartimin e projektit si edhe të kuadrit logjik duhet të fokusohet në çështje me të cilat stafit i duhet të përballet gjatë punës së tyre të përditshme. Gjatë kursit do të shpërndahen edhe materialet e trajnimit si edhe dokumente të tjera specifike.

Gjithashtu, trajnimi do të përmbajë edhe një modul mbi teknikat e mbledhjes së fondeve.

Pjesëmarrësit në trajnim do të caktohen nga Kryetari i Këshillit Rajonal në Kukës.

IV. Aktivitetet dhe afatet kohore

Aktivitetet e kësaj detyre pritet të fillojnë në muajin **prill 2014 dhe të përfundojnë në fund të muajit maj 2014.**

Duke kryer aktivitetet e lartpërmendura, ofruesi do të jetë përgjegjës për produktet e mëposhtme, të cilat përbëjnë edhe etapat kryesore:

Aktivitetet	Afati kohor
1. Përgatitja e materialeve të trajnimit (kopjet në gjuhën angleze dhe shqipe i duhen dorëzuar drejtuesve të projektit)	Deri në 14 prill 2014
2. Trajnim mbi MCP dhe mbledhjen e fondeve	Deri në 9 maj 2014
3. Raporti përfundimtar.	30 Maj, 2014

Të gjitha aktivitetet duhen diskutuar dhe dakordësuar me Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ILO) si edhe dorëzuar në letër dhe në formë elektronike.

V. Vlerësimi i performancës

Performanca e kontraktuesit do të vlerësohet në bazë të kriterëve të tilla si: respektimi i afteve kohore, përgjegjësia, inisiativa, komunikimi, saktësia dhe cilësia e produkteve.

VI. Planifikimet financiare

Detyrimi maksimal financiar i ILO-s (Organizata Ndërkombëtare e Punës) sipas kësaj kontrate është USD 4,000.

Shuma e lartpërmendur është shumë e përgjithshme dhe mbulon të gjitha kostot që lidhen me detyrën e caktuar, duke përfshirë, por jo vetëm, i) kostot e seancave të trajnimit që do të organizohen, duke përfshirë dhe ambientin ku do të kryhet ky trajnim; ii) udhëtimet e nevojshme në terren (duke përfshirë sigurimin) dhe kostot e komunikimit të kompanisë.

VII. Kërkesat

Kompanitë e interesuara që do të kontraktohen për kryerjen e detyrave të lartpërmendura duhen të kenë karakteristikat e mëposhtme:

- 1) Të jenë të regjistruara zyrtarisht si ndërmarrje/biznes;
- 2) Të mund të provojnë eksperiencën e tyre në fushën e MCP-së dhe mbledhjes së fondeve;
- 3) Të kenë në dispozicion stafin e përshtatshëm mësimor.

.....

Nëse kompania juaj i plotëson kërkesat e caktuara dhe nëse dëshironi të kontribuoni në projektin e lartpërmendur, ju lutemi të paraqisni, **brenda datës 4 prill, 2014 në orën 12:00 në mesditë, në adresën e mëposhtme**, Shprehjen tuaj të Interesit së bashku me: i) Përshkrimin teknik të detyrave të zbatimit, duke përfshirë edhe afatet kohore; ii) Çertifikatën e subjektit ligjor; iii) Listën e eksperiencave të kompanisë në fushën së cilës i përket kjo detyrë; IV) CV-të e trajnerëve të ngarkuar për të kryer trajnimin. Ju lutemi të shkruani "Shprehje interesi" në krye të emailit/tek subjekti dhe t'i referoheni titullit të Termave të Referencës.

Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) ruan të drejtën e pranimit ose refuzimit të çdo propozimi.

Z. Bukurosh Onuzi
Koordinator Rajonal për Kukësin
Adresa: Këshilli Rajonal i Kukësit
E-mail: buabon@yahoo.com
Cel: +355 692096645